

**AKT - THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“STARK SHIPPING AL” Sh.p.k.**

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve themelues te shoqerise me pergjegjesi te kufizuar “**STARK SHIPPING AL**” Sh.p.k. dhe me emer tregtare “**STARK SHIPPING AL**”, zoterohet nga ortaku:

- 1. Ramije Gjika**, shtetase shqiptare, lindur ne 05/01/1963 ne Ternove Shqiperi, rezident Tirane Shqiperi, identifikuar me numer personal Nr. G351050530.
- 2. Aljona Madani**, shtetase shqiptare, lindur ne 09/11/1997 Tirane Shqiperi, rezident Tirane Shqiperi, identifikuar me Nr.personal J76109060D.

Në përputhje me vullnetin e tyre te lirë dhe bazuar ne dispozitat e legjisacionit shqiptar, vendoset të hartojnë këtë akt themelimi të shoqërisë “**STARK SHIPPING AL**” Sh.p.k. mbi bazen e ketyre principeve:

**NENI 1
FORMA DHE EMRI**

Shoqëria ka formen e shoqërise me përgjegjësi të kufizuar, me iniciale SH.P.K., dhe i perballon humbjet deri ne kufirin maksimal te vleres se kontributit te ortakeve ne kapitalin themeltar. Emri i shoqerise “**STARK SHIPPING AL**” Sh.p.k.

**NENI 2
BAZA LIGJORE**

Shoqëria është themeluar dhe do të funksionoje në përputhje me ligjin Nr. 9723, datë 03.05.2007, Ligji me Nr.9901, datë 14.04.2008 në përputhje me legjisacionin shqiptar në përgjithësi, në përputhje me aktet e shoqërise si dhe në përputhje me marreveshjet nderkombetare te ratifikuara dhe qe do te ratifikohen në të ardhmen nga Republika e Shqipërise.

**NENI 3
SELIA**

Selia e shoqerise eshte ne adresen: RRAPO HEKALI 03910112; Nd. 34; H. 1; ; FARKË; SELITË; 1044; TIRANË, Shqiperi. Në adresën e mesiperme do të identifikohet qendra e personit juridik Me vendim te asamblese, mund të hapen dege, filiale, agjensi ose perfaqësi brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqiperise sipas fushave ne te cilat e ushtron veprimtarine shoqëria.

AKT THEMELIMI “**STARK SHIPPING AL**” Sh.p.k.

NENI 4

KOHEZGJATJA DHE PRISHJA E SHOQERISE

Shoqëria e zhvillon aktivitetin e saj për një afat të pa përcaktuar në kohë, duke filluar nga data e regjistrimit ne organin kompetent. Shoqëria prishet dhe kalon në procedure likujdimi, sipas rasteve te parashikuara me ligj.

NENI 5

OBJEKTI I VEPRIMTARISE

Shoqeria “**STARK SHIPPING AL**” SH.P.K është e organizuar ne formen e saj juridike si një shoqëri me pernjegjesi te kufizuar e cila operon ne fushen e tregtise dhe shitjes me pakice dhe shumice ka si objekt të veprimtarise së saj:

5.1 Perpunim kontenieri , sherbime spedicionere, agjensi doganore, shit-blerje autoveturash te reja dhe te perdonura, makina me qira, transport kombetar dhe nerkombetar mallrash.

Për të arritur objektivat, kompania, me vendim të organit kompetent, mund të marrë pjesë direkt ose indirekt në veprimtari ekonomike ose kompani të tjera, shqiptare dhe të huaja, të veprimtarive të ndryshme. Pjesëmarrja në kursin për të cilin lloji i tyre nuk parashikon përgjegjësi të kufizuar, është rregulluar më parë në asamblenë shoqërore

NENI 6

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar i shoqërise është 600.000 Lek i ndare në 2 (dy) pjesë. Kapitali themeltar i shoqërise zoterohet nga:

1- Ramije Gjika	51% - 306.000 Lek
2- Aljona Madani	49% - 294.000 Lek

Kapitali themeltar i shoqërise do të shlyet tërësisht dhe depozitohet ne një llogari të hapur në emër të shoqërise në një nga bankat e nivelit të dyte.

NENI 7

AKTET E SHOQERISE

Shoqeria do te rregullohet, perveç këtij akt-themelimi edhe me norma te percaktuara ne statutin e saj, i cili do të nënshkruhet nga ortakët e shoqërise dhe si i tillë do të miratohet në ditën e regjistrimit si person juridik në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

ORGANET DREJTUESE

Organet drejtuese të shoqërise do të janë Asambleja e Përgjithshme e Ortakeve dhe Administratori. Shoqëria mund të emëroj më shume se një administrator. Në çdo rast, kur

AKT THEMELIMI “**STARK SHIPPING AL**” Sh.p.k.

termi "Administrator" përdoret për të përcaktuar administratorët e shoqërise "STARK SHIPPING AL" Sh.p.k., ky term nënkupton të gjithë administratorët e saj sado qofshin këta në numer. Përveç organeve të parashikuara më sipër asambleja e ortakëve mund të krijoje edhe organe të tjera drejtuese, në aktet e krijimit të këtyre organeve do të përcaktohen kohezgjatja dhe kompetencat e tyre. Administrator i shoqërise për një periudhë 5 (pese) vjecare eshte emeruar:

Aljona Madani, identifikuar me numer personal Nr.J76109060D.

NENI 9
DISPOZITAT E FUNDIT

Çdo mosmarrveshje a konflikt në lidhje me themelimin, regjistrimin, funksionimin dhe likujdimin e kësaj shoqërie, ortakët do angazhohen se do të zhgjidhin me mirëkuptim, dhe në rast se kjo nuk arrihet kompetente për gjykimin e mosmarrveshjeve a konflikteve të mundshme do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqesorë Tirane.

Ky akt themelim është hartuar në 2 (dy) ekzemplare.

09/08/2022

ASAMBLEJA E ORTAKOVE TE SHOQERISE
"STARK SHIPPING AL" Sh.p.k.

Ramije Gjika



Aljona Madani



AKT THEMELIMI "STARK SHIPPING AL" Sh.p.k.